

KONTRATË PËR SHITJEN E KUOTAVE TË SHOQËRISË “ALBITALIA GROUP” SH.P.K.

Sot, më 15.02.2021, lidhet kjo kontratë për shitjen e kuotave të Shoqërisë “ALBITALIA GROUP” Sh.p.k. (në vijim të referuar si “Kontrata”), midis Palëve të mëposhtme:

Baftjar Zeqaj, lindur më 15.02.1961 në Verbas, Fier, shtetas shqiptar, madhor dhe me zotesi të plotë për të vepruar, banues në adresën: Lagjja 8 shkurti, Fier, - mbajtës i pasaportës me nr. personal G10215104L;

Nikolin Nikolini, lindur më 23.12.1971 në Patos, Fier, shtetas shqiptar, madhor dhe me zotesi të plotë për të vepruar, banues në adresën: Patos, Fier, - mbajtës i pasaportës me nr. personal H11223046A, (në vijim të referuar si “Shitësi”);

Dhe

- Agron Ahmetaj, i biri i Muharrem-it, lindur më 19.04.1973 në Fier, me kombësi shqiptare, madhor dhe me zotesi të plotë për të vepruar, banues në adresën: : Lagjja Malas, Ndërtesa private njëkatshe, Banesa nr.39, Fratar-Mallakaster, - mbajtës i pasaportës me nr. BE0072219 me nr. personal H30419094F, (në vijim referuar si “Blerësi”).

Shitësi dhe Blerësi në vijim do të referohen bashkërisht si “Palët”.

DUKE PASUR PARASYSH QË:

- Shoqëria “ALBITALIA GROUP” Sh.p.k. është një shoqëri me përgjegjësi të kufizuar, e regjistruar në Qendrën Kombëtare të Biznesit me NIPT: L72623407F, me seli në Fier, në adresën: Lagjja Afrim i Ri, Rruga Çerçem Çela, Nr.Pasurie 13/1, Zona Kadastrale 8534, Fier, e përfaqësuar nga Administratori z. Baftjar Zeqaj, 50% e kuotës të së cilës zotërohet nga ortaku, z. Baftjar Zeqaj, dhe 50% e kuotës të së cilës zotërohet nga ortaku, z. Nikolin Nikolini.
- Ortakët e Shoqërisë, Baftjar Zeqaj dhe Nikolin Nikolini, synojnë të shesin kuotat e tyre, që përbëjnë gjithsej 100% të kuotave të shoqërisë;
- Z. Agron Ahmetaj ka shprehur gadishmërinë për të blerë kuotat e zotëruara nga Ortakët e Shoqërisë.

Për sa më sipër, Palët bien dakord si vijon:

Neni 1

Objekti

1.1 Objekti i kësaj Kontrate është kalimi e kuotave së Shoqërisë, si më poshtë:

- Ortaku i Shoqërisë z. Baftjar Zeqaj i shet z. Agron Ahmetaj kuotën e tij në Shoqëri që përbën 50% të kuotave të shoqërisë.
- Ortaku i Shoqërisë z. Nikolin Nikolini i shet z. Agron Ahmetaj kuotën e tij në Shoqëri që përbën 50% të kuotave të shoqërisë.

1.2 Me nënshkrimin e Kontratës, Blerësit Agron Ahmetaj i kalonë 100% e kuotës së shitësit dhe në këtë mënyrë Blerësi bëhet Ortaku i Vetëm në Shoqëri.



Blue ink signatures of Nikolin Nikolini and Agron Ahmetaj.

Neni 2

Çmimi

- 2.1 Çmimi i shitjes së kuotës së Shoqërisë “ALBITALIA GROUP” sh.p.k. është e barabartë me 100.000 (njëqindmijë) Lekë, korrespondente me 100% të kuotës së kapitalit themeltar të shoqërisë, përkatesisht,
- Z.Baftjar Zeqaj është përfitues i shumës prej 50 000 (pesëdhjetëmijë) lekë, për shitjen e kuotës së tij, dhe
 - Z.Nikolin Nikolini është përfitues i shumës prej 50 000 (pesëdhjetëmijë) lekë, për shitjen e kuotës së tij.

Neni 3

Garancitë

- 3.1 Shitësit deklarojnë se janë të vetmit titullar të ligjshëm të kuotave që po transferohen nëpërmjet kësaj Kontrate dhe se ato janë të lira nga çdo barrë apo pretendim tjetër ligjor.

Neni 4

Të drejtat dhe detyrimet e Palëve

- 4.1 Shitësit deklarojnë se, me nënshkrimin e kësaj kontrate, i kalojnë Blerësit gjithsej 100 % të kuotave të Shoqërisë në pronësi të tyre, së bashku me të gjitha drejtat e tjera të lidhura me to.
- 4.2 Blerësi fiton pronësinë mbi 100 % të kuotave të Shoqërisë me të drejta të plota.

Neni 5

Të ndryshme

- 5.1 Pas kalimit të kuotave me nënshkrimin e kësaj Kontrate, Agron Ahmetaj bëhet zotërues i ligjshëm sipas legjislacionit shqiptar, i kuotës së vetme të shoqërisë, në masën 100% të kuotave të Shoqërisë, ndërsa Shitësit Baftjar Zeqaj dhe Nikolin Nikolini zhvishen nga pronësia dhe çdo e drejtë mbi 100 % të kuotave të Shoqërisë.
- 5.2 Kjo Kontratë është hartuar në përputhje me dispozitat e legjislacionit tregtar shqiptar dhe për çështje, të cilat nuk janë rregulluar posaçërisht në këtë Kontratë, Palët do t'i referohen legjislacionit shqiptar në tërësi.
- 5.3 Të gjitha mosmarrëveshjet që mund të lindin midis Palëve në lidhje me këtë kontratë do të zgjidhen me mirëkuptim midis Palëve. Në rast të kundërt, organi kompetent për zgjidhjen e tyre është Gjykata e Rrethit Gjyqësor Fier.
- 5.4 Kontrata nënshkruhet nga Palët, sot, në 4 (katër) kopje origjinale në gjuhën shqipe.

Emrat dhe Nënshkrimet:

BLERËSI:


Agron AHMETAJ

SHITËSIT:


Baftjar ZEQAJ


Nikolin NIKOLINI

